

VENDIM
Nr.365, datë 19.5.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË“, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshili i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen “Formati tip nr.5-Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, të përmendur në pikën 9 të kreut II “Kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për pajisjen me vizë”, të vendimit nr.362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen edhe:

“...Rusia dhe Ukraina me dokumentin pasaportë, për periudhën 30 maj deri në 31 tetor 2010...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha